

MODELI PËR DOKUMENTIN KONSULTATIV

“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për Gjendjen Civile”, të ndryshuar”

Ministria e Brendshme fton qytetarë, organizata të shoqërisë civile, ekspertë të fushës, shoqata dhe përfaqësues të tjerë të publikut të interesuar për të kontribuar përgjatë procesit të konsultimit publik të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për Gjendjen Civile”, të ndryshuar”.

Ministria e Brendshme mirëpret:

Komente të përgjithshme publike mbi përcaktimet e projektaktit, kryesisht mbi:

- Reformën e ndërmarrë nga Qeveria e Shqipërisë për riinxhinierimim e shërbimeve publike, ku pjesa më e madhe e tyre ofrohen “on-line”, në bazë të aksesit të shtetasve në portalin qeveritar unik “e-albania”.
- Njëtrajtshmërinë e identitetit të personit me qëllim shmangien e çdo pengese administrative që mundëson lëvizjen e lirë, duke pasqyruar dhe evidentuar në mënyrë të saktë përbërësit e gjendjes civile për të cilat shërbimi i gjendjes civile është përgjegjës.

Kontributet tuaja do të konsiderohen përgjatë procesit të përmirësimit të mëtejshëm të projektligjit.

Ministria e Brendshme do të përmbledhë të gjitha sugjerimet dhe komentet tuaja dhe do të japë sqarime për mënyrën se si ato janë reflektuar në projektakt, edhe në rast se mendimet nuk reflektohen.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimi publik do të zgjasë 1 muaj, nga data 14 nëntor 2023 deri më 14 dhjetor 2023.

Si të përgjigjeni:

Mund të merrni pjesë në procesin e konsultimeve publike duke dërguar komente/kontribute për projektin:

- Duke plotësuar formularin online të Regjistrin Elektronik për projektligjit, në adresën elektronike: <http://www.konsultimipublik.gov.al>:
- Me email duke dërguar propozimet/sugjerimet tuaja në adresën e koordinorit të konsultimit publik për Ministrinë e Brendshme, Sara Shameti, në adresën: Sara.Shameti@mb.gov.al

Kontakti:

Të dhënat e kontaktit të koordinatorit përkatës për konsultime publike dhe/ose të ndonjë personi tjetër të cilit i drejtohen pyetjet:

Znj. Sara Shameti - Koordinatore e Konsultimit Publik, e-mail: Sara.Shameti@mb.gov.al

Znj. Irida Zogolli - Përgjegjëse, Drejtorja e Hartimit të Procedurave dhe Kontrollit, DPGJC e-mail: Irida.Zogolli@mb.gov.al

Datat dhe vendet e takimeve publike:

- Në zbatim të urdhrin nr. 57, datë 28.04.2023 të Ministrit të Brendshëm "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.05.2009 "Për gjendjen civile"", të ndryshuar, në datën 16.05.2023, u mbajt takimi i parë i grupit të punës, I kryesua nga z. Andi Mahila, Zëvendësministër i Brendshëm, në ambjentet e Ministrisë.
- Më datë 14.06.2023, u zhvillua takimi i dytë i grupit të punës për diskutimin nën për nen të ligjit nr. 10 129, datë 11.05.2009 "Për gjendjen civile", të ndryshuar, dhe u diskutua lidhur me përafrimin e legjislacionit dhe nënshkrimin elektronik, duke qenë se në kuadër të qeverisjes digjitale shumë shërbime të gjendjes civile që ofroreshin fizikisht tanimë ofrohen online, duke shtuar nevojën e futjes së këtij koncepti në ligj.
- Në datën 19.06.2023, u mbajt takimi i tretë i grupit të punës, me pjesëmarrjen e anëtarëve. Në këtë mbledhje, fillimisht u diskutua lidhur me masën e ndërhyrjes në ligjin e gjendjes civile, ku u përcaktua se në bazë të vlerësimit të masës së ndërhyrjes në dispozitat aktuale në fuqi, nuk kemi të bëjmë me ndryshimeve substanciale dhe si rrjedhojë do të kemi rishikim/ndërhyrje në këtë ligj dhe jo një ligj të ri.

Sfondi i propozimit legjislativ

Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10129, datë 11.5.2009 "Për gjendjen civile", të ndryshuar"", propozohet në kuadër të reformës së ndërmarrë nga Qeveria e Shqipërisë për riinxhinierimim e shërbimeve publike, ku pjesa më e madhe e tyre ofrohen "on-line", në bazë të aksesit të shtetasve në portalin qeveritar unik "e-albania".

Me zbatimin e reformës është shtuar gama e shërbimeve "on-line" për qytetarët, të cilëve krahas dokumenteve me nënshkrim elektronik të prodhohen me të dhënat e Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGjC) të vitit 2010, u mundësohet dhe përfitimi i dokumenteve të tjerë që më parë lëshoheshin nga zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative dhe zyrat e arkivës së gjendjes civile pranë prefektit të qarkut në sportel.

Në këtë mënyrë për shtetasit shqiptarë ofrohet një shërbim pa kosto, duke shmangur prezencën e nevojshme, kontaktin me nëpunësit e gjendjes civile në sportel, si dhe kohën fizike që më parë kërkohej për tërheqjen e dokumenteve në zyrat e gjendjes civile sipas organizimit të tyre, sipas amendimeve përkatëse.

Propozimet ligjore sipas këtij projektligji adresojnë gjithashtu zgjidhjen e problematikave të ndeshura gjatë zbatimit të tij, referuar ceshtjes kryesore që ka të bëjë me globalizimin, ku një pjesë e konsideruarshme e shtetasve shqiptarë zhvillojnë aktivitetin e tyre jetësor jashtë vendit.

Propozimet

Projektligji i propozuar synon të përmirësojë disa aspekte të zbatimit të ligjit nr.10129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, që lidhen kryesisht me:

- njëtrajtshmërinë e identitetit të tyre me qëllim shmangien e çdo pengese administrative që mundëson lëvizjen e lirë, duke pasqyruar dhe evidentuar në mënyrë të saktë përbërësit e gjendjes civile për të cilat shërbimi i gjendjes civile është përgjegjës.

Vlen të theksojmë se në shërbimin e gjendjes civile duhet të pasqyrohen vetëm ato përbërës që janë marrë në përputhje me ligjin e shtetit të huaj dhe jo ato që mund të jenë ndryshuar në mashtrim të tij, i referohemi këtu regjistrimeve që disa shtetas shqiptarë kanë patur në shtetin e huaj, duke deklaruar të pavërteta për sa i përket regjistrimit të tyre fillestar në Shqipëri, të cilat nuk mund të gjejnë pasqyrim;

- një prej veprimtarive kryesore që propozohet të përmirësohet ka të bëjë me rregullimin e procedurave për vendbanimin, regjistrimin e vendqendrimit të shtetasve të huaj, si dhe qartësimin e veprimeve që lidhen me dokumentimin e faktit juridik të lindjes së fëmijës, i referohemi këtu fëmijëve që lindin të vdekur, si dhe në modalitete të mëtejshme që duhet të ndjekin nëpunësit e gjendjes civile në bashki / njësi administrative gjatë lidhjes së martesës, etj.

Pyetjet

Jeni të ftuar të jepni komentet dhe kontributet tuaja për të gjitha aspektet e projektligjit të propozuar. Për më tepër, ne kemi zgjedhur pyetjet e mëposhtme ku kontributi juaj do të jetë veçanërisht i vlefshëm, dhe të cilave mund t'i përgjigjeni duke plotësuar një pyetësor të shkurtër në internet.

- Si mendoni se mund të ndikojë ky projektligj në përmirësimin e shërbimeve për shtetasit jashtë territorit të RSH?